



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Antifashizmi popullor tek shqiptarët
Konferencë shkencore ndërkombëtare
Në kuadrin e 75-vjetorit të Çlirimit

Miratuar me vendim të Kryesisë nr. 16, datë 31.07.2019

Tiranë, 2019

Titulli i konferencës	Antifashizmi popullor tek shqiptarët
Institucioni organizues	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Bashkëpunojnë:	<ul style="list-style-type: none"> - Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës - Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedonisë së Veriut - Instituti i Historisë, Kosovë
Komisioni shkencor	<ul style="list-style-type: none"> - Akad. Floresha Dado (ASHSH) - Akad. Marenglen Verli (ASA) - Akad. Jusuf Bajraktari (ASHAK, Kosovë) - Prof. dr. Sabit Syla (Instituti i Historisë, Kosovë) - Prof. dr. Martin Berisha (Mali i Zi) - Prof. dr. Skënder Asani (Maqedonia e Veriut, ITSHKSH) - Prof. dr. Romeo Gurakuqi (UET) - Prof. dr. Shaban Sinani (ASHSH)
Qëllimi	1. Të evokohen traditat më të rëndësishme të antifashizmit tek shqiptarët referuar burimeve të reja dokumentare, si një dukuri pankombëtare, duke tejkaluar disa koncepte dhe teza të

	<p>shkencave historiografike jashtë vendit, sipas të cilave shqiptarët kanë pasur dy qendrimë: një brenda Shqipërisë shtetërore dhe një tjetër në pjesën tjetër të hapësirës historike shqiptare, jashtë kufijve;</p> <p>2. Të lartësohet Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe vepra e dëshmorëve, duke pasuruar traditën e studimeve shkencore cilësore të realizuara ndër vite nga personalitete të dijes, anëtarë të Akademisë dhe të institucioneve dikur në vartësi të saj.</p> <p>3. Të dëshmohet baza e gjerë popullore e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si themeli i suksesit të ushtrisë partizane, duke evokuar, përveç rezistencës së armatosur, edhe pjesëmarrjen masive popullore, në qendresën për fitore;</p> <p>4. Të dëshmohet kostoja njerëzore dhe materiale që ka paguar populli shqiptar për fitoren anti-fashiste, duke iu referuar konceptit të qendresës kundër pushtimit si lëvizje e armatosur, si rezistencë popullore, si lëvizje mendimi dhe si qendrim konvergjent i shqiptarëve;</p> <p>5. Të sillen burime dhe argumente të reja që shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore kanë qenë popull antifashist dhe Shqipëria - fuqi aleate, që ka kontribuar në fitoren botërore dhe rëndësia e këtij qëndrimi në ditët e sotme;</p> <p>6. Të sillen prova e burime se antifashizmi ka qenë prirja sunduese edhe në Kosovë e Çamëri.</p>
<p>Pjesëmarrës nga:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Akademia e Shkencave e Shqipërisë; - Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës; - Akademia e Studimeve Albanologjike; - Instituti i Historisë, Kosovë; - ITSHKSH, Maqedoni e Veriut;

	<ul style="list-style-type: none"> - Universiteti i Tiranës; - Universitete të tjera publike dhe jopublike; - Qendra dhe institucione të tjera kërkimore; - Studiues të njohur të historisë së shqiptarëve nga bota: Sir Noel Malcolm, prof. Roderick Baily, prof. dr. Berndt Fischer, dr. Miranda Vickers, prof. dr. Michele Sarfatti etj. - Studiues të lirë.
Veprimtari të lidhura	<ul style="list-style-type: none"> - Konkurs për veprën më cilësore kushtuar anti-fashizmit në Shqipëri në periudhën 1991-2019; - Përurime botimesh të reja nga autorë të huaj me mbështetjen e institucionit: a) <i>Eight hour from England</i> (Anthony Quayle) dhe b) <i>Wildest Province: SOE Missions in Albania</i> (prof. Roderick Bailey) – shih informacionin plus.
Kalendar	13-16 nëntor 2019
Procedimi	Për herë të parë Akademia e Shkencave zbaton thirrjen publike për shprehje interesi shkencor dhe vlerësimin me <i>Proceeding</i> të pranimit të kontributeve shkencore.
Shtesa	<p>Për më shumë shih:</p> <p>http://akad.gov.al/ash/pdf/Vendim_nr_16_dt_31_korrik_2019.pdf</p> <p>http://akad.gov.al/ash/njoftime/njoftime-ash/12-te-reja/479-75-vjetori</p>